

KONTRATË THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “OLTI” SH.P.K.

Sot më datë 14.06.2024, në Sarandë, me vullnetin tim të lirë, une i nënshkruari:

- **Ervis REKA**, i biri i Sylejman-it, lindur më 20 Janar 1985 në Kuçovë, dhe banues në Kuçovë, mbajtës i ID Nr. 033925573 dhe numër personal I50120001J me datë lëshimi 11.02.2019

në zbatim të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe Ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” ,

Neni 1

Vendosa te themelojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “**OLTI**” shpk.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- ❖ Bar-Restorant, Fast-Food
- ❖ Shitje dhe blerje pasurive të paluajtshme
- ❖ Import dhe eksport i mallrave, produkteve të ndryshme, mjeteve për vete dhe të tjerë
- ❖ Aktivitete në fushën e turizmit,
- ❖ Organizimi i guidave turistike
- ❖ Shërbime hotelerie

Neni 3

Ortakt themelues të shoqërisë është:

Ortaku themelues: **1- Ervis REKA**

Neni 4

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën e 10,000 (dhjetëmijë) lekë, dhe përbëhet nga një kuote, e ndarë si më poshtë:

1. Ortaku themelues **Ervis REKA** zotërues i 1 (një) kuotë me vlerë 10,000 (dhjetë mijë) lekë ose 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë,

Neni 5

Selia e shoqërisë është: Lagjja Nr.1, rruga Butrinti, Godina nr.250, kati i pare, Sarandë 9701.

Neni 6

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar në kohë dhe fillon që nga momenti regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 7

Administrator i shoqërisë do të jetë z. **Ervis Reka**, i cili do të qëndrojë në këtë detyrë pa afat, me të drejtë rizgjedhje dhe është i ngarkuar të kryejë akte dhe marrë angazhime që janë në përputhje



me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 8

Personaliteti juridik i shoqërisë fitohet me regjistrimin e saj në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Aktiviteti i saj do të fillojë pas kryerjes së procedurave ligjore.

Në aktivitetin e shoqërisë do ti përmbahem statutit të hartuar për këtë qëllim dhe do të respektoj legjislacionin në fuqi.

Kjo kontratë themelimi u redaktua në tre kopje, me vlerë të njejtë ligjore, një kopie dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, një kopje dorëzohet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë dhe një kopje ortakut themelues të shoqërisë.

ORTAKËT E SHOQËRISË “OLTI” SH.P.K.

Ervis REKA _____

